



Gumilak Metal Primer

Astar për sipërfaqet prej metali dhe izolues papastërtish



Rendimenti i mbulimit: 14 - 18 m²/lt



Koha e tharjes: e thatë për tu prekur për 1 - 2 orë, thahet plotësisht për 3 - 4 orë.



Hollimi: 4 % për vëllim në White Spirit për aplikim me furçë/rul, ose deri në 4 % në Holluesin nr. 1 të Vechro për aplikim me pistoletë me spërkatje



Mundësia për shtresë të dytë: 6 - 10 orë



Paketimi:

E bardhë: 375 ml, 750 ml, 2,5 lt, 5 lt, 10 lt

Gri: 750 ml, 2,5 ml

Aplikimi: Me furçë, rul, pistoletë me spërkatje

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Substrati me bazë rrëshira sintetike, me përmbajtje të ulët të POA dhe me pak aromë gjatë aplikimit. Është i përshtatshëm për lyerjen me astar të sipërfaqeve prej metali dhe izolimin e njollave në tavane dhe/ose në sipërfaqet prej druri. Ka ngjitje të shkëlqyer, mundëson punim të thjeshtë, përhapet në mënyrë të njëtrajtshme, smerilohet lehtë dhe rilyhet shpejt duke përdorur bojëra ose llaqe akrilike me smalt.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shkëlqimi	Me shkëlqim me një indeks shkëlqimi prej 10 - 25 njësi në 60°.
Graviteti specifik	1,54 - 1,57 kg/lt (I bardhë), 1,53 - 1,56 kg/lt (Gri).
Rendimenti i mbulimit	14 - 18 m ² /lt për shtresë.
Hollimi	Deri në 4 % për vëllim në holluesin WHITE SPIRIT për aplikim me furçë ose rul, për aplikim me pistoletë për spërkatje pa ajër deri në 4 % për vëllim me holluesin nr. 1 të VECHRO.
Koha e tharjes	E thatë për t'u prekur në 1 - 2 orë, thahet plotësisht për 3 - 4 orë, në varësi të kushteve të motit dhe nuancës.
Mundësia për shtresë të dytë	Rilyhet pas 6 - 10 orësh dhe pas ngurtësimit të plotë të shtresës së parë. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta dhe me lagështirë.
Kategoria e POA	a. "Dekorime të brendshme/të jashtme dhe veshje prej druri dhe metali". Lloji D. Vlera e pragut të POA = 300 gr/lt. b. "Astarë izolues". Lloji D. Vlera e pragut të POA = 350 gr/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 295 gr/lt. Boja gjithashtu përmban tretës jo POA. Plotëson kërkesat e Ligjit pas vitit 2011. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e zierjes < 250 °C.
Ngjyra	E bardhë dhe gri.



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni plotësisht sipërfaqet nga pluhuri, vajrat, bojërat e mëparshme, pjesët e lirshme, ndryshku, etj. Aplikoni letër smerili dhe pastrojini nga pluhuri. Për mbrojtje kundër gërryerjes në sipërfaqet prej metali, rekomandohet të aplikohet fillimisht një shtresë e astarit kundër gërryerjes OXIDOL.

APLIKIMI

Përziemi mirë përpara përdorimit. Aplikoni një ose dy shtresa të astarit Gumilak Metal në mënyrë të njëtrajtshme. Si bojë përfundimtare mund të aplikoni Gumilak metal, Smaltolux extra ose çdo llak VECHRO.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në enë dhe pastrojini ato me tretësin nr. 1 të VECHRO, me ujë të nxehtë dhe sapun. Nëse boja thahet, ajo mund të hiqet vetëm me detergjente të fortë. Mos i zbrazni ujërat që keni larë mjetet në ujërat nëntokësorë.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30 °C dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ripërdorimi i ngjyrave mund të minimizojë ndjeshëm efektet në mjedis të ciklit të jetës së produkteve.

SHËNIME

Më shumë informacion mund të gjeni në Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Materialit të produktit (FDSP).

UDHËZIME PËR PËRDORIM TË SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve



Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001,14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.